

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. / Br. 35108/25

Nr. i fq. / Br. st. -4-

Data: / Datum: 22.07.25

VUSHTPRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtrri



**Kuvendi i Komunës**

**01 Nr. PB 125/25, 22/07/2025**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 16 qershor 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Adnan Lahu, Agron Perçuku, Fakete Dushi, Sylejman Mehollu dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Hava Mlinaku (Nënkryetare e komunës), drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na ka ardhur një pikë shtesë për ta shtuar në rend të ditës: “Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin, Bastri (Hajzer) Beqiri”.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi që të shtohet në rend të ditës pika shtesë.***

***Komiteti për Politikë dhe Financa me njëzëri aprovoi këtë:***

**R E N D D I T E**

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19.05.2025;
2. Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2026-2028 dhe kalendari kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë;
3. Raporti për legalizim për vitin 2024;
4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri (Hajzer) Beqiri;
5. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 19.05.2025.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 19.05.2025.***

2. Draft - Korniza Afatnesme (KAB) për vitet 2026-2028 dhe kalendari kohor për mbajtje të takimeve publike me qytetarë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – siç e dini, si çdo vit tjetër edhe këtë vit do t'i organizojmë dëgjimet buxhetore me qytetarë. Drejtori i financave do të na i sqarojë çështjet tjera, ku përveç KAB-it, do ta hartojmë edhe kalendarin e dëgjimeve buxhetore, me grupet punuese që do të marrin pjesë në këto dëgjime. Vitin e kaluar kemi pasur mjaft vështirësi, por të shohim nëse do të angazhohemi më shumë gjatë këtij viti.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me kalendarin për mbajtje të takimeve publike, pasi të caktohen anëtarët e KPF-së që do të marrin pjesë, është mirë që kur të shkojmë në dëgjime buxhetore, t'i kemi si material kërkesat e viteve paraprake, sa prej tyre janë kryer dhe sa prej tyre janë në realizim. Kjo, për shkak se po jemi në një situatë të palakmueshme në raport me qytetarët, sepse nuk po kemi përgjigje lidhur me kërkesat e tyre.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – kërkoj nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që për të gjithë anëtarët e KPF-së të na përgatis materialin me listën e projekteve të realizuara, të atyre që janë në realizim e sipër dhe projekteve që pritet të fillojnë.

Me këtë pikë, ne duhet t'i përcaktojmë edhe grupet punuese lidhur me dëgjimet buxhetore. Secili le të përcaktohet për vendin se ku dëshiron të merr pjesë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Raporti për legalizim për vitin 2024.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – deklaroi se ky është një raport qesharak, ku informatat janë shumë të mangëta. Në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka shumë kërkesa për legalizim. Në raport thuhet se: “Në mungesë të stafit të pa mjaftueshëm në DUMM, nuk ka pasur mundësi të shqyrtohen kërkesat brenda afatit ligjor, por shqyrtohen kërkesat që palët i kërkojnë me urgjencë, të tjerat janë në pritje për shqyrtim”. Dikush duhet të merret me shqyrtimin e këtyre kërkesave. Cilat janë kriteret që një kërkesë të klasifikohet si urgjente dhe të shqyrtohet? Në bazë të këtij raporti po i bie se kush ka lidhje dhe të njohshëm i kryen legalizimet, kush nuk ka lidhje – janë në pritje për shqyrtim dhe kush e di kur shqyrtohen. Kërkoj nga drejtoria që për kuvend të vjen një informatë shumë më e detajuar dhe të përfshijë periudhën që nga fillimi i procesit të legalizimit e deri më sot. Po ashtu, kryetari së bashku me drejtorin ta shikojnë mundësinë e zgjerimit të stafit, të marrin zyrtarë nga drejtoritë tjera, ku ka staf shumë të përgatitur dhe të merren intensivisht me legalizime.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – pajtohem me parafolësin, sepse ndoshta e ka menduar ndryshe për ta thënë, por e shkruar ndryshe. Në raport thuhet: “Në mungesë të stafit të pa mjaftueshëm”. Kjo i bie që ka staf më shumë sesa që duhet. Mund të thuhet “në mungesë të stafit mjaftueshëm”. Ka nevojë për informacione shumë më të detajuara lidhur me raportin e legalizimit, jo vetëm për vitin 2024, por në përgjithësi për katër vitet e fundit. Ajo çfarë po e shohim në qytet që gjithandej ka ndërtime, të cilat në shumicën e rasteve, janë nis, leju e përfundu pa leje. Pastaj, të legalizohet në forma tjera, qysh janë duke e praktikuar. Nuk kemi raporte lidhur me ndërtimet me leje, me legalizim të qartë asnjëherë,

gjatë këtyre katër viteve. Kemi vetëm statistika, por jo përshkrim të procesit. Qytetarët janë duke vuajtur shumë çështjen e ndërtimeve, ku shpeshherë edhe po i dëmtojnë në pronat e tyre, kurse inspektorati i komunës nuk po merr asnjë masë. Këtu nuk e kemi prezent kryetarin e komunës dhe asnjë drejtor dhe kjo flet shumë për seriozitetin e qeverisjes. Nuk e kemi të aprovuar PZHK-në, e mos të flasim për Harta Zonale që kanë mbetur fontanë dëshirash të iluzioneve të kryetarëve edhe atij paraprak, por edhe këtij aktual. Vushtrria është kthyer në një kaos urban të komunikacionit, ku sot u detyrova të sillem rrotull nga bllokadat që po shkakton prerja e asfaltit vend e pavend, nevojë e panevojë, e që e ka vështirësuar shumë jetën në Vushtrri.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – u tha shumë nga parafolësit, por kisha kërkuar edhe unë që në kuvend të na vjen një raport më i detajuar. Sa i përket mungesës së stafit, komuna ka staf të mbingarkuar dhe nuk e di qysh s'po ka staf për ta kryer një punë. Apo, ndoshta nuk po iu konvenon sa i përket kësaj drejtorie, sepse punët duhet të kryhen nga lart.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesues e KK-së dhe e KPF-së** – sa i përket stafit, në këtë drejtori duhet të jetë staf profesional dhe jo staf nga drejtoritë tjera. Kurse, për të marr staf të ri pajtohem edhe unë. Por, ku të gjenden, sepse arkitekti nuk vjen për të punuar në komunë.

**Hava Rruka Mlinaku, nënkryetare e Komunës** – deklaroi se dy apo tri herë është anuluar konkursi për arkitekt në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për shkak se aplikuesit nuk i kanë plotësuar kriteret. Kurse, raporti ka të bëjë vetëm me vitin 2024. Mund të kërkojmë nga drejtorja që ta bëjë një raport më të detajuar, si dhe të rregullohen gabimet teknike.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – e kuptoj që nuk keni mundur të sillni profesionist të fushës në këtë drejtori, por keni sjell militant nëpër drejtori tjera, ku e keni stërngarkuar komunën, madje edhe NPL "Përparimi". Ajo tha se nuk duhet arkitekt apo inxhinier që ta përgatis një raport të statistikave, sepse këtë mund ta bëjë një jurist. Prandaj, kjo nuk është arsye se nuk kemi arkitekt në drejtori. Mjafton të mblidhen kërkesat dhe të paraqiten në raport.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – e kam parasysh që raporti është vetëm për legalizime. E dimë që procesi i legalizimit ka qenë i sponzorizuar nga Qeveria e Kosovës. Prandaj, ka qenë afat i caktuar kohor si në Vushtrri dhe komunat tjera, ku qytetarët kanë mundur të aplikojnë për legalizimin e objekteve pa leje. Ky afat ka përfunduar dhe sot nuk mund të dorëzohen kërkesa për legalizim. Pra, këto kërkesa duhet të shqyrtohen.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – si qeverisje keni paguar mijëra euro në emër të blerjes së shërbimeve profesionale. Cilat shërbime janë blerë? Cili është kontributi i atyre njerëzve? Pse nuk janë blerë shërbime në urbanizëm që keni nevojë? Cilin plan të komunës e kanë shtyer përpara këta njerëz? Cilin projekt e kanë hartuar që komuna të përfitoj nga fondet e IPA-s? Nëse koeficienti i arkitektit dhe ndërtimitarit është i vogël dhe komuna ka nevojë, pse nuk janë blerë këto shërbime. Keni punësuar njerëz vetëm me ju bërë zgjidhje për fushatë elektorale. Nuk keni bërë zgjidhje profesionale. Këta njerëz kanë marrë vetëm paga nga taksat e qytetarëve për me pi kafe gjithë ditën. I kemi edhe dy drejtorë që nuk kanë fare buxhet e as staf, kurse marrin pagë vetëm drejtorët.

**Hava Rruka Mlinaku, nënkryetare e Komunës** – nuk ka pasur staf të mjaftueshëm në drejtori, pikërisht për shqyrtimin e këtyre kërkesave. Sepse, e dimë që raportin mund ta bëjnë edhe juristët. Kemi provuar të blejmë shërbime edhe në urbanizëm, por na e ka anuluar KRRP-ja, me arsyetimin se për këto pozita mund të merren zyrtar me konkurs të rregullt.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – sa është numri aktual i konsulentëve që janë të angazhuar?

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – deklaroi se aktualisht janë të angazhuar tre konsulentë: Një në zyrën e kryetarit, një në Drejtorinë për Prokurim dhe një në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të përgatitet një raport i detajuar që nga fillimi i procesit të legalizimit e deri më sot dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Propozim – vendim për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri (Hajzer) Beqiri.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – e mbështesim këtë propozim-vendim dhe kërkesën e familjarëve për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri (Hajzer) Beqiri, i cili ra heroikisht në mbrojtje të Junikut. Është nder, krenari dhe hijeshi për lokalitetin vendosja e lapidarit. Besoj që kjo të realizohet sa më parë, por shpresoj që edhe pas të ndërtimit të ketë edhe mirëmbajtjen e duhur. Prandaj, komuna përmes shërbimeve të NPL “Përparimit” të merret me mirëmbajtjen e këtyre monumenteve.

**Adnan Lahu, anëtar i KPF-së** – edhe ne e përkrahim këtë propozim-vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri (Hajzer) Beqiri.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

5. Pyetje dhe përgjigje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50.

**Bujar Klinaku**

  
Procesmbajtës

  
**Melihate Basholli - Latifi**  
Kryesuese e KK-së dhe KPF- së